



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 416/5 prot.

Tiranë, më 3.12.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Ibrahim Hoxha
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 19.11.2020, është njoftuar vendimi nr. 316, datë 17.11.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Ibrahim Hoxha, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ibrahim Hoxha, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 76/2016, datë

22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti, z. Hoxha, i është nënshtruar procedurës së rivlerësimit bazuar në shortin e hedhur më datë 15.6.2020, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit pranë Komisionit”. Rezulton se janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dhe nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka dërguar dokumentacion të plotë, ndër të tjera edhe vendimin nr. 30, datë 9.5.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), mbi shkarkimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Ibrahim Hoxha, për shkak se është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

4. KLGJ-ja është shprehur, ndër të tjera, se *ndaj gjyqtarit Ibrahim Hoxha është marrë masë disiplinore e shkarkimit nga funksioni, nga organi kompetent sipas ligjit të kohës, ish-KLD-së, vendim kundër të cilit, gjyqtari i shkarkuar nuk ka paraqitur ankim brenda afatit të përcaktuar në ligji. Për këtë arsye, vendimi 30, datë 9.5.2017, i ish-KLD-së, konsiderohet se ka marrë formë të prerë, duke passjellë dhe efektet juridike përkatëse. Nisur nga kjo, në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të shkronjës “ç” të nenit 64, të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor konfirmon se z. Ibrahim Hoxha i ka mbaruar statusi i magjistratit.*

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 316, datë 17.11.2020, ka vendosur: “Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Ibrahim Hoxha, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit” .

6. Ky vendim është marrë nga Komisioni mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 , në pikën 2/b të nenit 140 të Kushtetutës, në germën “ç” të pikës 1, të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 95 të Kodit të Procedurës Administrative.

7. Komisioni, duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Hoxha, nuk ka statusin e magjistratit, ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjellë si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, pasi neni 95 i Kodit të Procedurës Administrative parashikon “*pamundësinë në objekt apo qëllim*”, ndaj dhe organi publik deklaroi të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

8. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

9. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

10. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

12. Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 316, datë 17.11.2020, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni, për deklarinimin të përfunduar të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Ibrahim Hoxha, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore në fuqi, ndaj dhe ka shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'ia paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

13. Për sa më sipër, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, ushtrohet bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016.

14. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, arsytimi dhe vendimmarrja e Komisionit nuk gjen mbështetje në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore në këto drejtime: (1) të efektit të mbarimit të statusit të magjistratit në procesin e rivlerësimit; (2) të rasteve kur vendoset ndërprerja e procesit të rivlerësimit apo përfundimi i procesit të rivlerësimit pa vendim përfundimtar.

15. *(1) Efekti i mbarimit të statusit të magjistratit në procesin e rivlerësimit*

15.1 Shkaqe për mbarimin e ushtrimit të detyrës si gjyqtar apo prokuror, referuar Kushtetutës, janë ato të parashikuara në nenin 140, pika 2, nenin 148/d, pika 2, të Kushtetutës, dhe krahas tyre edhe “moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit”, sipas nenit 179/b, pika 7 e saj. Ndërkohë, neni G i aneksit të Kushtetutës parashikon ndërprerje të procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes nga detyra.

15.2 Sipas sanksionimeve kushtetuese, shkaqet janë të pavarura nga njëri-tjetri, ndaj dhe secili prej shkaqeve qëndron më vete si masë disiplinore, si rrjedhojë shkaku i shkarkimit, pasi magjistrati është dënuar me vendim të formës së prerë për një krim, nuk mund të shërbejë si shkak *per se*, për moskalimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

16. (2) *Rastet kur vendoset ndërprerja e procesit të rivlerësimit apo përfundimi i procesit të rivlerësimit*

16.1 Kushtetuta, konkretisht neni 179/b, pika 3, parashikon se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

16.2 Në interpretim literal të sa më sipër, Kushtetuta e lidh fillimin e procesit të rivlerësimit për magjistratët për shkak të ushtrimit të detyrës/*ex officio*, ndërsa përfundimin apo ndërprerjen e procesit me aplikimin e masave disiplinore të nenit G të aneksit të Kushtetutës, nenit 56 dhe nenit 58 të ligjit nr. 84/2016. Kushtetuta dhe ligji i rivlerësimit kalimtar, nuk parashikojnë që mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e procedurës administrative pa një vendim përfundimtar.

16.3 Në raport me qëndrimin e Komisionit se *mbarimi i statusit sjell përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar*, vendosim në vëmendje institutin e *Dorëheqjes*, të parashikuar nga neni G i aneksit të Kushtetutës, si rast në të cilin kemi humbjen e statusit të magjistratit si rezultat i situatës faktike të dorëheqjes, situatë të cilën dispozita kushtetuese e ka me përcaktim negativ të drejtash.

16.4 Kolegji, në vendimin (JR) nr. 1/2018, në të cilin ka bërë një trajtim zgjerues mbi institutin e dorëheqjes, si dhe me kërkesë të Komisionerit Publik, ka orientuar Komisionin për rastet e dorëheqjes në çdo fazë të procesit, ndër të tjera, ka shprehur qëndrimin se: *shkak kushtetues i moskalimit me sukses të procesit të rivlerësimit përbën dhe instituti i dorëheqjes, i sanksionuar nga neni G, me titull dorëheqja në Kushtetutë.....shoqëruar shprehimisht me përcaktim negativ të drejtash, siç është ndalimi i ushtrimit të profesionit. Pika 2 e nenit G të Kushtetutës sanksionon: “2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli....., për një periudhë 15-vjeçare”.*¹ Në drejtim të arritjes së qëllimit të saj, vetë Kushtetuta, me bazë prezumimin në favor të masës disiplinore, ka përcaktuar dhe ndalimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli ...për një periudhë 15 vjet, pavarësisht se këto subjekte nuk janë më mbartëse të statusit të gjyqtarit.²

16.5 Po ashtu vlerësojmë se përfundimi i procesit të rivlerësimit si rezultat i aplikimit të masave disiplinore të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 84/2016, ndaj subjekteve të rivlerësimit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, vendoset pas vlerësimit të shkaqeve dhe provave të administruara nga organet disiplinore apo ato të rivlerësimit, sipas rastit, pas një procesi të bazuar në prova dhe duke respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

¹ Referohuni paragrafit 63 të vendimit (JR) 1/2018, të Kolegjit.

² Referohuni paragrafit 71/72 të vendimit nr. 1/2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese.

16.6 Në dallim nga këto raste, disponimi me shkarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Hoxha, si rezultat i një vendimi penal të formës së prerë, do të ishte pasojë e një situatë faktike kushtetuese, e cila, në vetvete, nuk kërkon një proces vlerësimi dhe vendimmarrjeje nga organet përkatëse.

16.7 Komisioneri Publik vlerëson se, për efekt të procesit të rivlerësimit, janë organet e reja kushtetuese të rivlerësimit që do të vendosin përfundimisht mbi këtë situatë faktike dhe për pasojën që sjell në procesin e rivlerësimit të subjektit Hoxha, pavarësisht humbjes së statusit nga subjekti i rivlerësimit.

16.8 Komisioni dhe Kolegji i Apelimit, si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, janë të pajisura me kompetencën për të vlerësuar në substancë kushtet e kalimit me sukses të procesit për subjektet e rivlerësimit që i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* dhe konfirmimin në detyrë.

16.9 Komisioni dhe Kolegji janë, gjithashtu, institucione kompetente për të vlerësuar shkaqet e moskalimit me sukses të procesit të rivlerësimit të cilat, bazuar në nenin 179/b, pika 7 e Kushtetutës, përbëjnë shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.

16.10 Komisioni, në rastin konkret, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, ka vendosur për përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar. Vërejmë se Komisioni nuk ka arsyetuar se ku qëndron *pamundësia në objekt apo qëllim*, sipas të cilës, është marrë vendimi bazuar në nenin 95 të K. Pr. Administrative. Kjo situatë krijon paqartësi mbi ecurinë e procesit të rivlerësimit në rastet kur masat disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe mbarimi i statusit merren nga juridiksione të tjera përtej atyre të rivlerësimit.

16.11 Sa më sipër arsyetuar, Komisioneri Publik vlerëson si zgjidhje të kësaj situatë faktike atë të *deklarimit të ndërprerjes së procesit pa vendim përfundimtar*. Ky dispozitiv e klasifikon rastin sipas parashikimeve kushtetuese të nenit 179/b, pika 8, sipas së cilit, pas shpërbërjes së Komisionit, *çështjet e papërfunduara* të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor³.

16.12 Marrë shkas nga formulimi i pikës 8, neni 179/b i Kushtetutës, ku thuhet se: “...Pas shpërbërjes së Komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor...” , formulimi në pjesën e dispozitivit të vendimit nr. 316/2020, të Komisionit, duhet të jetë i qartë, nëse ky vendim përfshihet në kategorinë e çështjeve të përfunduara apo në atë të çështjeve të papërfunduara. Në vlerësim të Komisionerit Publik, marrë parasysh rrethanat e veçanta të çështjes, ku rezulton se subjekti, z. Hoxha, në momentin e vendimit të Komisionit ishte pa status të gjyqtarit për shkak të vendimmarrjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. 30, datë 9.5.2017, pikërisht në këtë moment nuk gjente zbatim pika 3 e nenit 179/b të Kushtetutës, që parashikon se i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio* të gjithë gjyqtarët. Si rrjedhojë, për shkak se një rrethanë e re ligjore (vendimi i KLD-së) ka ndërhyrë në procesin e rivlerësimit kalimtar, pra në juridiksionin e

³ Çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

institucioneve të rivlerësimit, vendimmarrja e Komisionit duhet të kufizohet në deklarinimin se procesi i rivlerësimit kalimtar është ndërprerë dhe çështja bie në kategorinë e çështjeve të papërfunduara sipas pikës 8 të nenit 179/b, të Kushtetutës.

16.13 Ndërkohë konstatojmë se disa nga dispozitat e vendosura në bazën ligjore të vendimit nr. 316/2020, për subjektin e rivlerësimit, z. Hoxha, janë tej kuadrit ligjor që rregullon procedurën e rivlerësimit dhe, më konkretisht, dispozita kushtetuese, neni 140, pika 2, germa “b” e Kushtetutës, si dhe neni 64, pika 1, germa “ç” e ligjit nr. 96/2016, të cilat i përkasin juridiksionit të zakonshëm (atij disiplinor) të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për sa i përket referimit në dispozitat tjera, që janë në bazën ligjore, dhe, më konkretisht, pika 6 e nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, në vendimin e Komisionit mungon arsyetimi se cilat janë ato shkaqe që çojnë në zbatimin e nenit 95 të Kodit Procedurave Administrative, në rrethanat konkrete të çështjes.

16.14 Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit si shkak kushtetues për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës së magjistratit, parashikuar në pikën 7, të nenit 179/b, të Kushtetutës, është i zërthyer në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, konkretisht, në kriteret mbi të cilat merret vendimi, neni 4, si dhe rastet e parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016. Pra, baza ligjore për vendimmarrje të institucioneve të rivlerësimit është e kornizuar në këtë kuadër dhe në kufijtë e këtyre shkaqeve.

IV. Kërkimi i ankimit

17. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

18. Referuar pikës 3, të nenit F të aneksit të Kushtetutës, ku sanksionohet se: “3. Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe, si i tillë, bazohet te kriteret e përcaktuara në këtë ligj”;

19. Referuar pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, ku sanksionohet se: “2. Kolegji i Apelimit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme”;

20. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 316, datë 17.11.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me këtë përmbajtje: “1. Të deklarojë të ndërprerë procesin e rivlerësimit kalimtar, për subjektin e rivlerësimit, z. Ibrahim

Hoxha, për shkak të humbjes së statusit të magjistratit, pasi është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”; si dhe

- Të orientojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme mbi nevojën për saktësimin e bazës ligjore, arsyetimin ndryshe të vendimit dhe, sipas vlerësimit të Kolegjit, saktësimin e dispozitivit në pikën 1 të tij.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA